



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-30020/23
Kaçanik, 16.11.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 24 nëntor 2023 (e Premte), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të KPF-s të datës 24.11.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;
3. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj, Gabrricë, Doganajj, Sllatinë, Ivajë;
4. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë kosovare për distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);
5. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme;
6. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-27138/23
Kaçanik, 25.10.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 tetor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi, Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Ramadush Osmani-DSHPE, Dardana Tafili Dauti –DAP, Zahir Doda-DA.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu- Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 25 tetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, pronën komunale, kompanisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike -KEDS, për vendosjen e trafostacioneve;
6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;
7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
8. Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;
9. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023;
10. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023.

Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, zyrtarja e KK kam qenë në kontakte të vazhdueshme me mua për dërgim të materialeve, për shkak të pengesave që po ka, se shumica nga ju nuk i përdorin emailët zyrtarë, ndërkaq në emailët private është problem ngarkimi me shumë material. Ata që kanë pasur pengesa, materiali i është dërguar përsëri.

znj. Ardita Rrahmani: Shprehi shqetësimet e saja për problemet me emailët zyrtarë. Këtë çështje duhet ngritur si shqetësim në që po kemi probleme. A duhet për këtë çështje me i shkruar ministrit apo zyrtarit të IT. Unë kam komunikuar me zyrtarin e IT, po nuk kishte qenë këtu.

Kryetari i Komunës: Për probleme me emailë zyrtarë i shkruani zyrtarit të IT këtu. Atëherë konstatohet me kaluar në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri me një korrigjim teknik. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII(tetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 22.09.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-24305/23.

2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i Buxhetit dhe Financave, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi-DBF: Buxheti i deritashëm në krahasim me buxhetin e miratuar, ka lëvizje buxhetor. Buxheti i miratuar, 10,674,689€, ndërkaq me bartjen e mjeteve 11,138,045.91€. Shpenzimet buxhetore janë 7,056,309,97€, progresi në përqindje 63.10 % krahasim me vitin e kaluar të njëjtën periudhë kemi ngritje për 1,974,709.70€, indeksi 38.86%, për shkak të ngritjes së pagave dhe shkalla me e lartë të IK. Sipas kategorive, Pagat dhe mëditjet janë shpenzuar 81.44%, Mallrat dhe Shërbimet 50.72%, Shpenzimet komunale me 37.74%, Subvencionet dhe Transferet 45.30%, Investimet kapitale 42.12%, e që kanë progres për 86.24% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të HVK 85.08% i kemi realizuar direkte, ndërsa indirekte vetëm i kemi paraqitur, nuk janë pjesë e planifikimeve se këto vinë prej organizatave tjera, ne vetëm i pranojmë dhe të drejtën e shfrytëzimit. Të hyrat për të cilat kemi ndikim ne, janë 85.08%, ka tejkalim të tatimit në pronë, lejet e ndërtimit kanë realizim të mirë, ka ndonjë lloj i të hyrave që ka edhe ngecje, në përgjithësi si total janë mirë të realizuara.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Faleminderit për sqarimet drejtor. Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, të Pagat dhe mëditjet, 81.44% është e mirë, se kompensimet janë obligim ligjor, ndërkaq shqetësuese është realizimi mjeteve të Investimeve kapitale, 42.12%.

z. Agim Mani: Edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim me parafolësen, të Investimet kapitale, që theksoj se është 42.14%, shpenzimi i mjeteve KESH është vetëm 20%. Duke marrë parasysh nëntëmujorin, mjetet e shpenzuara nuk kanë arritur me u realizuar sipas planifikimit. Nëse vazhdohet me këtë trend, nuk ka me u arritur realizimi i planifikuar deri në fund të vitit. Kërkoj sqarime të të HVK të inkasuara, të shfrytëzimi i pronës publike, të planifikuara 15.000€, të inkasuara 4,000€ (nuk po shkoj me shifra të sakta, por të përafërta). Në bazë të kësaj del se ky është keq planifikim. Të DUKMM, taksat tjera administrative, 500€ të planifikuara, 177 € të realizuara. E mora këtë shifër se në 6 mujorin e parë janë mbledhë 177€, ndërsa në nëntëmujorin, me pak se këto mjete apo 143€, mund të jetë gabim teknik. Të certifikata e

lindjes, keni arritur me i koduar në vendin e duhur. Të hyrat indirekte është i saktë planifikimi dhe inkasimi, apo e tejkalojnë deri në fund të vitit. Të Shpenzimet, kërkoj sqarime, të rregullimi dhe montimi i rrjetit të kabinave dhe rrethoja të stadiumi i qytetit, 8,392€, nuk e pash këtë shumë të asnjë drejtori, as të Mallrat dhe shërbimet e as të Investimet kapitale Kërkoj sqarime për shpenzimet kontraktuese, shuma 126, 000€ dhe për shpenzimet e druve për nxehje, shuma 129,000€. Të mirëmbajtja e rrugëve, shpenzimet kanë tejkaluar shumë, krahasuar me tremujorin e fundit. Të planifikimi urban, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale, është shuma 220,000€, janë shpenzuar 199,000€, ndërkaq planifikimi me buxhet ka qenë 190,000€. A është bërë rishikimi i buxhetit që është ndryshuar shuma në këtë program shpenzues buxhetor.

z. Bahri Selimi: Të rregullimi dhe montimi i rrjetit të kabinave dhe rrethoja të stadiumi, mjetet janë të mallrat dhe shërbimet. Rishikim të buxhetit nuk ka pasur, por janë bërë ndryshime me vendime të KK. Të shpenzimet për Investimet kapitale, nëntëmujori mbyllet me 30 shtator, ndërkaq me 1 tetor fillon tremujori i fundit. Nuk është keq gjendja e realizimit të shpenzimeve, ndërkaq në raportin vjetor tregohet saktë realizimi i shpenzimeve. Ka do shpenzime që nuk mundem me i paguar menjëherë, ndërkaq fizikisht progresi i shpenzimeve në teren është në përmbyllje sipas drejtorëve që i raportojnë menaxherëve, aq sa është punuar paguhen. Të mjetet KESH, nuk është fjala për mjete në kesh, por është kategoria ekonomike e shpenzimeve nuk i vjen 20%, por diku 42%. Total buxheti i shpenzuar është 7,056,309.97€, ku në këtë shumë, pagat kanë marrë pjesë afër 56%. Hisja sa ka marrë pjesë në totalin e buxhetit Investime kapitale është 20%. Krahasimi behët sa është ndarë buxhet për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve, dhe sa është realizuar nga buxheti i ndarë.

z. Ramadush Osmani: Shuma 20% e shumës buxhetore, është hisja sa kanë marrë pjesë në totalin e buxhetit Investimet kapitale.

Kryetari i Komunës: Sqaroj se kategoria KESH, nuk i vjen 20%, por 42.12% kategoria ekonomike e shpenzimeve të Investimet kapitale.

z. Qamil Stagova: Shuma për investime kapitale është 3,428,203.30€ e buxhetit, ndërkaq përqindja e shpenzimeve në këtë kategori shpenzuese buxhetore llogaritet në kuadër të kësaj shume.

z. Ramadush Osmani: Edhe në planifikim është e njëjta renditje, ashtu siç janë realizuar: Pagat dhe Mëditjet, Investimet kapitale, Mallrat dhe shërbimet, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe transferet.

z. Bahri Selimi: Vendin e parë në shpenzime e zënë Pagat dhe mëditjet 56% realizim. Kishte me qenë shqetësuese nëse Investimet kapitale renditen në vendin e tretë apo të katërt, por janë në vendin e dytë, janë diku mbi 20.46 %, mallrat e shërbimet 10.8%, pastaj i kemi subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet komunale. Shpenzuesi me i madh është Drejtoria e arsimit me mbi 50% e shpenzimeve të buxhetit, shëndetësia 13%, drejtoritë komunale me 37%. Të HVK direkte e kalojnë planifikimin, ato indirekte janë aq sa na kanë ardhur janë shënuar në planifikim dhe realizim, se janë jashtë dorës tonë, por ju i keni kërkuar se unë kam pasur mundësi me një raport tjetër me raportuar për këto të hyra, ato i inkason policia, gjykatat dhe Agjencinë i pyjeve të Kosovës, nëse janë brenda territorit, alokohen dhe shpenzohen te ne. Për 6 mujorin të jap një përgjigje për planifikimin e tyre, se nuk e kam këtu raportin. Të stadiumi i qytetit, me kod janë 5,000€, e kemi bërë shumë 10,000€, ju jeni në ngjarje për transfert që po i bëjmë në KK, ku kemi pasur në dy mbledhjet e fundit transfer të mjeteve të rrugët lokale. Buxheti i aprovuar po ndryshon, se po hynë edhe të hyrat e bartura, dhe i kemi dërguar në rrugë lokale. Një sqarim me të thukët mundem me dhënë edhe në KK.

z. Agim Mani: Të projekti që e potencova, është përfunduar projekti ndërkaq nuk i pash mjetet që janë paguar. Për atë unë e bëra pyetjen për shpenzimet e shërbimeve kontraktuese.

z. Bahri Selimi: Shpenzimet e shërbimeve kontraktuese, 80% janë shpenzimet për sigurim të objekteve. MEFT nga viti i ardhëm kanë hapur kod të veçantë, ku mjetet për sigurim fizik shkojnë në atë kod, se deri tani i kanë lënë të shpenzimet kontraktuese tjera. Ka shumë mjete aty, se çmimet e sigurimit fizik janë shtrenjtuar.

z. Agim Mani: Unë e ngrita këtë çështje, se është kryer projekti, nuk është bërë pagesa. Nëse i shikojmë kontratat, të Shkolla e mesme “Skënderbeu” plani dinamik ka kaluar. Mua me interesoj projekti, se atë projekt duhet me mbikëqyrë dikush. Kabinat janë rrëzuar përtokë, ndërkaq nuk janë vendosur kabinat e reja, kjo është shqetësuese.

z. Ramadush Osmani: Pasi të kryhet projekti, e sjellë situacionin, ndërkaq afati për pagesë është 30 ditë nga dita e pranimit teknik të projektit. Në rregull jemi këtu, nëse është kryer projekti, e ka sjellë situacionin menaxheri, 30 ditë ka afat për pagesë. Ky projekt nuk është të unë, por rrethojat nuk kanë qenë në projekt, kanë qenë vetëm kabinat.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundeni informatën me marrë në zyre te drejtorit, që mos të flasim këtu pa pasur informacion të saktë dhe me zgjatur debati.

Kryetari i Komunës: Në mbledhje të KK japim informacione me në detaje rreth këtij projekti.

z. Bahri Selimi: Rrethojat nuk kanë qenë, kanë qenë vetëm kabinat. Pasi të pyes Zyrën prokurimin, të jap informata me të sakët, se mundem me gabuar. Të shpenzimet e druve, 114,000€ janë të administrata, 115,000 € janë të arsimit. Të Mallrat dhe shërbimet, kemi shpenzuar mjete me shumë për sigurimin fizik të objekteve dhe për dru për nxehje. Dihet se qysh është inflacioni, rritja e çmimeve. Të rrugët lokale nuk ka dallim, vetëm 10,000€ janë më shumë për mirëmbajtje. Çdo 1€ që investohet në kapitale, 0.30€ duhet me i ndarë për mirëmbajtje për vitin vijues, se është normale që mirëmbajtja e projekteve (rrugë, ndriçim publik) shkon duke u ngritur.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Vitin e kaluar jemi furnizuar me dru për nxehje me kontratë tjetër, ajo kontratë ka skaduar, kontrata e re ka çmim me të lartë, normal se janë rritur edhe shpenzimet. Njëjtë është edhe të çështja e sigurimit fizik të objekteve, pagat janë rritë të punëtorëve dhe kjo ka ndikuar në rritje të shpenzimeve të buxhetit të kjo kategori shpenzuese buxhetore.

z. Agim Mani: Shpenzimet e vendimeve të gjykatave, 9,500€, për cilën pronë është fjala, se janë bukur shumë mjetet me i humbur kontestet?

z. Bahri Selimi: Kur i bëjmë raportet i nxjerrim shifrat, 5321€ janë të shëndetësia, 1852€ janë të arsimit, të urbanizmi 1536€. drejtori i dinë më mirë këto shpenzime.

z. Zahir Doda: Të arsimit ka shuma të mjeteve të shpenzuara për konteste të humbura lidhur me kontratën kolektive. Tani presim të jenë edhe me shumë konteste të humbura të arsimit.

z. Qamil Stagova: Në DUKMM, tani ka ardhur një pagesë 2700-2800€, për arsye se në të kaluarën një personi komuna ia ka dhënë vendin për ndërtimin e një shtëpie, mirëpo kjo ka mbetur vetëm në vendim, se në shënimet kadastrale prona nuk është bartë në emër të tij. Komuna nuk ia ka pranuar, kështu e ka fituar me gjyq atë të drejtën e pronës, ndërkaq shpenzimet e gjykatës i bartë komuna.

z. Agim Mani: Për gabimet e komunës, shpenzimet po i bartin taksat e qytetarit.

z. Bahri Selimi: Shpenzimet e gjykatave na përcjellin nga vendimet e mëhershme, janë do shpenzime që na dalin pa i menduar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është e vazhdueshme, kushdo që vjen, kanë me përcjellë shpenzimet e gjykatave. A jeni që kjo pikë t'i shkoj KK si informatë? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se,

KPF e shqyrtoj Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023. Ky raport financiar i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.

3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Sqarime të nevojshme na jep drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Ju falënderoj që na mirëkuptuat në seancën e 27 shtatorit 2023 për këtë pikë e cila ishte në rend pune, ndërkaq e hoqëm nga rendi i punës se e patëm një raport të MKRS se lokacioni nuk paraqet vlera arkeologjike dhe e tërhoqëm këtë pikë. Me datë 12 tetor ka ardhur vendimi që nuk lejohet me u bërë ndërtimi i parkingut, për kundër përpjekjeve të kryetarit me drejtoreshën, kështu kemi bërë propozim vendimin për rialokim të mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Të shuma e mjeteve, 110,000€ janë planifikuar për këtë projekt, 10,000€ janë realizuar, 89,000 € transferohen, ndërkaq ku po mbetet shuma prej 10,000€?

z. Bahri Selimi: Shuma 10,000€ janë shpenzuar me herët, 10,000€ janë nga të HVK të cilat mundemi me i shpenzuar me vonë. Rialokimi bëhet për mjetet nga Granti qeveritar, të cilat nuk mundemi me i shpenzuar me vonë.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Ne me datën 27 shtator kemi kërkuar me pasur një vendim për ose kundër punimeve. Në shkresë na ka ardhur, që konkludojnë se nuk ka gjetje, ndërkaq pas një ore është mbledhë kabineti dhe na ka thënë mos me punuar në këtë drejtim. Çështja është, ku është serioziteti i qeverisë, ku janë profesionistët e asaj lëmi, ku është vendimi që ata e kanë nxjerrë. Në vazhdimisht kemi kërkuar takim me kryetarin me kontaktuar me ta, kemi diskutuar shumë rreth kësaj çështje në takimet me ta, me datën 12 tetor na i kanë dërguar një vendim, që kërkojnë me i ndërprerë punimet. Nuk jemi kundër se ne nuk jemi profesionist, por pse nuk e bënë me datën 27 shtator kur ne kërkuam, se e patëm çështjen në KK me bërë rialokimin e mjeteve dhe na u dashtë me tërhequr propozim vendimin dhe tani përsëri bëhet rialokimi e mjeteve, plus mundemi me u rrezikuar me mjete, edhe pse e kemi planin për projektin e nxehjes se objektit të administratës komunale. I kujt është faji në këtë rast Agim?

Kryetari i Komunës: Jemi shumë vonë për shpenzimin e mjeteve të grantit qeveritar, kjo është arsyeja.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky vendim me u bërë i plotfuqishëm, duhet një muaj, pastaj janë procedurat e prokurimit. Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtoj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e :

Aprovoj

Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023/ Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Janë dhënë në arsyetim pse bëhet ky transer dhe mjetet që transferohen se ku kanë me shkuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime nuk ka, atëherë këtë pikë e shtoj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023/ Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, pronën komunale, kompanisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike - KEDS, për vendosjen e trafostacioneve;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i DUKMM Qamil Stagova është këtu për sqarime të nevojshme:

z. Qamil Stagova: Kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i punës, për me u përgatitur lënda më mirë, se nuk e kemi përmendur shumë për pagesë dhe kemi gabuar në bazën ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse bëhet me pagesë, atëherë duhet me shkuar përmes ankandit publik. Pasi është në të mirë të qytetarëve, mirë është me ua ofruar këtë mundësi KEDS, se qytetarët tonë e meritojnë me pas energji më të mirë, në qoftë se ata janë të interesuar me investuar. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Pse u vonua deri sot kjo çështje me na ardhur në KK, kur dihet se kërkesa është bërë që 6 muaj ?

Kryetari i Komunës: Me letër nuk kam diçka në këtë drejtim, por kontaktet me drejtorin përmes telefonit kam pasur. Ai ka kërkuar që t'i japim sinjal për shkak të një kontesti të trafos, para 2 jave me ka thirr me ka thënë tani mundeni me proceduar lëndën.

z. Agim Mani: A janë të gjitha pronat shoqërore apo ka edhe private?

Kryetari i Komunës: Ata kanë bërë kërkesë edhe për pronat private, por ne ato nuk i procedojmë në KK, se ata e bëjnë zgjidhjen me persona privat.

Kryesuesi i Kuvendit: A jeni që kjo pikë të hiqet nga rendi i punës. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se kjo pikë HIQET nga rendi i punës.

6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, kërkesa ka qenë e kahershme e komunitetit, se në varrezat e Doganaj nuk ka më vend. Ndërkaq sipas Ligji për vetëqeverisje lokale, komuna ka obligim të siguroj lokacion për varreza. Është një pjesë të Fusha e Mulës, ku komuniteti kanë kërkuar që një pjesë të jetë për varreza. Çështja e lokacioneve për varreza, ka me na përcjellë në vazhdimësi. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj me ditur saktësisht lokacionin, shihet se sipërfaqja është 1.5ha.

Kryesuesi i Kuvendit: Është pjesa e shpatijeve të Fusha e Mulës, për varreza është e përshtatshme ajo pjesë, duhet me u thurë vendi dhe me u bërë me etazhe. Diskutime nuk ka, atëherë këtë pikë e shtoj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë/ Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Ne çdo herë kemi marrë vendim për formimin e komisionit për hartimin e planit të punës së KK. vendimi aprovohet në KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë kjo pikë u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024/ Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;

9. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Në KK e elaborojmë këtë çështje, ndërkaq si renditje mendoj se është dashur të jetë informata si në pikën 9 para pikës 8. Përfundimi i vitit shkollor është dashur të raportohet në muajin shtator.

Kryesuesi i Kuvendit: Rënditjen e ka bërë sekretaria ashtu siç i ka ardhur materiali.

z. Zahir Doda: Informata për fillimin e vitit të ri shkollor është protokolluar me 14.09.2023, ndërkaq është çështje e administratës që ka mbetur në rrugë për shkak të teknologjisë. Për këtë tjetrën, keni të drejtë, por kjo është kështu në planin e punës së KK. Për hera tjera kur të mbledhet komisioni, të diskutoj këtë çështje se cila me u diskutua e para.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne në Planin e punës së KK e bëjmë një renditje, për një arsye, se informata për fillimin e vitit të ri shkollor mund të jetë në fillim të shtatorit, sepse DA përgatitet për fillimin e vitit të Ri shkollor, ndërkaq për përfundimin e vitit shkollor, mundet për shkak të statistikave, ofrimit të raporteve nga drejtorët e shkollave munden me u vonuar të dhënat. Ndërkaq për fillimi i vitit shkollor nuk munden me u vonuar të dhënat. Ka pasur raste që fillimi i vitit shkollor është trajtuar 1 mbledhje ose 2 para raportit për përfundimin e vitit shkollor.

znj. Ardita Rrahmani: Pajtohem se mundet me pasur ndryshime, se ka ndodhë me pasur lëvizje të nxënësve nga shkolla në shkollë qysh në fillim të vitit. Unë e di se transporti i nxënësve bëhet për ata të SHMP, ndërkaq ka qenë një publikim në rrjetet sociale nga një qytetar i f. Gllaboçicë (Ahmet Luma) se transporti se i nxënësve është falas për të gjithë nxënësit. Kjo është padrejtësi të nxënësve tjerë, duke pas parasysh barrën e shpenzimeve që bëjnë për me

ardhur deri këtu. A është lëshim i tij apo ka diçka të vërtetë në këtë drejtim. Ndërkaq sa unë e di unë, komuna i mbulon shpenzimet vetëm për nxënës të SHMP.

z. Zahir Doda: Sa i përket shqyrtimit të Informatave të DA në fund të tetorit, të dyja janë të vonuara.

Kryetari i Komunës: Mbulimi i shumës 50% të mujores së transportit, ka qenë edhe me herët për nxënësit e Gllloboçicës, për shkak të largësisë.

z. Zahir Doda: Deri parvjet ka qenë 50% e mbulimit të shpenzimeve të shkollave të mesme të Gllloboçicës, Strazhës dhe Kottina, zona malore këto. Në vitin e kaluar SHMP i mbulohen të gjithë mujorja, ndërkaq 50% për gjimnazin, ndërkaq në këtë vit kemi lëvizur diçka për tri zonat malore, Gllloboçicë, Ivajë, Kottinë.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk jemi kundër, por pse duhet një qytetar i thjeshtë kjo informatë ? Pse mos me pasur ne me herët këtë informatë nga DA apo Kryetari i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Ai e ka bërë informatën në formë private, se ka njerëz që janë me të interesuar me i ditur këto punë. Ka njerëz që e dinë planin e komunës për krejt rrugët nga kanë me u shtruar, para neve.

Kryetari i Komunës: Ne e kemi përcjellë informatën adiministratorit, ndërkaq ai e ka marrë sigurisht përmes tij dhe e kanë shpërndarë.

z. Zahir Doda: Ka njerëz kureshtar, që e shpërndajnë informatën para meje, megjithëse nuk kam njohuri për këtë. Në zonat malore jemi duke i përkrahur nxënësit, për shkak të shpërnguljes, dhe distancës së madhe. Të Gllloboçica kemi pasur informatën se donë me shkuar nxënësit në shkollat e Tetovës.

znj. Kadrije Lika-Troni: A është bërë ndonjë zgjidhje për nxënësit e Kovaçecit, shkak i komibusëve që kanë probleme, nxënësve po iu duhet me udhëtuar me kombi të Biçecit dhe po iu bien gati 2 orë me ndenjur rrugëve. Ky është shqetësim shumë i madh, ka shumë ankesa nga ana e prindërve, unë për këtë çështje i kam shkruar edhe drejtorit të drejtorisë.

z. Zahir Doda: Nuk është bërë ndonjë zgjidhje.

z. Ramadush Osmani: Nuk ka operatorë të interesuar, kjo është çështje e biznesit privat. Mundësia është, nëse kompania që operon për Dubravë, me shkuar kah rruga e Kovaçecit, unë e kam njoftuar kompaninë lidhur me këtë çështje.

znj. Kadrije Lika-Troni: A e ka pranuar kërkesën e juaj kompania që operon për Dubravë?

z. Ramadush Osmani: Ajo e shikon çështjen e interesit të vet.

Kryesuesi i Kuvendit: Pse nuk dalin të rruga nxënësit e Kovaçecit, sepse sa km. iu bien me udhëtuar atyre nxënësve, iu bien edhe fshatrave tjera?

znj. Kadrije Lika-Troni: Është fjala për nxënësit e Kovaçecit që janë në largësi me të thellë, se problem rreziku paraqet çështja e qenve endacak, se po ka shumë qenë, se nxënësit e Kovaçecit që janë më afër, dalin në rrugë.

Kryetari i Komunës: Nxënësit vullnetin e kanë, por ne nuk po mundemi me i detyruar kompanitë. Ata me pasur mundësi me gjetur një kombi, ne nuk jemi kundër, si kërkesë e kemi adresuar dy herë, nuk ka pasur të interesuar për shkak se nuk kanë pasur leverdi, kemi me provuar përsëri.

z. Agim Mani: Mirë është që mbulohen shpenzimet e udhëtimit për nxënësit e SHMP, ndërkaq është mirë me u bërë edhe për nxënësit e gjimnazit “Skënderbeu”.

Kryetari i Komunës: Është mirë Agim, por është vështirë me i mbuluar shpenzimet, se është kosto e lartë.

Kryesuesi i Kuvendit: kërkoj me ditur a ka diçka për shkollën në Doganaj, se shkolla e vjetër nuk ka kushte për mësim, saqë bien edhe krimbat. Nesër mundeni me u ballafaqua edhe me prindërit e nxënësve të asaj shkolle.

Kryetari i Komunës: Kemi kërkuar takim me zyrtarët e ministrisë, por nuk kemi përgjigje.

z. Zahir Doda: Çështja e shkollës është punë e ministrisë së Arsimit, por nuk po lëshojnë mjete, bëjnë investime në çerdhe të fëmijëve në komuna të caktuara, si Shtimje, ndërkaq nuk ka asgjë për këtë shkollë.

Kryetari i Komunës: Ministria e Arsimit ka bërë investime në Shtime për çerdhe të fëmijëve, 21 milion euro, ndërkaq të ne nuk kanë bërë investime.

znj. Ardita Rrahmani: Qysh po shihet se nuk ka investime në komunën tonë, është vështirë e realizueshme ndërtimi i çerdhes së fëmijëve, kështu me mirë është me rritur numrin e shtretërve të çerdhes së fëmijëve në Kaçanik.

Kryetari i Komunës: Në çerdhe e kemi të mbingarkuar edhe numrin e punëtorëve. Ashtu qysh kanë kërkuar ministria për çerdhet e reja, si çështjen e pronës etj. i kemi dërguar me vendim çdo gjë që kanë kërkuar. Premtimet i kemi që kanë me filluar në këtë vit ndërtimi i çerdheve të fëmijëve.

z. Zahir Doda: Në tender e kam rritur numrin e shtretërve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se KPF, **Njoftohet me,**

-Informatën e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;
dhe

-Informatën e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023.

Këto dy Informata i përcjellën Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

10. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, lëndën na e ke sjell pak me vonesë, arsyetona.

z. Bahri Selimi: Meqë mbledhja e radhës e KK është bukur vonë, nga Zyra e prokurimit na është bërë me dije se nuk është nënshkruar një kontratë, atëherë e kemi sjellë rialokimin e mjeteve vetëm të pjesës së grantit qeveritar. Nëse lidhet kontrata në vijim mundem me mbuluar me të HVK, krejt kjo për shpenzim të buxhetit në % sa më të madhe.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Drejtor, në një kod buxhetor kanë qenë të ndara, Ndërtimi i urave mbi lumin Neredime dhe Lepenc. Nëse nuk keni ditur ku me i adresuar këto mjete, unë e jap një propozim, i adresoni në Stagovë të ura.

Kryetari i Komunës: Janë në pyetje që kanë dështuar procedurat e tenderimit, jo urat se ura janë në qytet.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të di për kompaninë që nuk vjen me nënshkruar kontratën. A mundeni asaj kompanie me ia dhënë një vërejtje dhe me futur në listë të zezë që po na i humbë mjetet për papërgjegjësitë e saj ?

z. Ramadush Osmani: Kompania penalizohet për mos nënshkrim të kontratës, se ajo e deponon një garancion.

z. Agim Mani: Kompania e punon në bazë të projekti dhe planit dinamik? Atëherë qysh doni me i shpenzuar mjetet të rregullimi asfaltimi i rrugëve rurale ?

Kryetari i Komunës: I kemi edhe 52,000€ obligime. Për mos me i shpenzuar të HVK, po e shpenzojmë fillimisht grantin qeveritar, se granti na kthehet në qeveri. Ata janë në terren ende duke punuar, llogaritet se na vijnë pagesat, por i kemi mjetet nga të HVK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Pas përfundimit të pikave, Kryesuesi i Kuvendit, kërkoj të bëhet konfirmimi nga grupet e përfaqësuara në KK lidhur me, Vizitën studimore të organizuar në Shqipëri. Unë e lëshoj edhe një listë për nënshkrim në mbledhje të KK, se duhet të kemi paraprakisht një orientim.

z. Agim Mani: Nëse vizita realizohet vetëm me anëtarë të KK, ne vijmë, ndërkaq nëse ka edhe nga ekzekutivi, ne nuk marrim pjesë, se përndryshe është dashur me cekur në vendim.

Kryesuesi i Kuvendit: Askush në Kosovë nuk i ndan e as unë jo, se diskutimet dhe temat janë me ekzekutivin. Unë e kam për obligim me zbatuar vendimin e KK.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:10. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31.10.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik - Municipality Kaçanik



01.Nr.

Data

40462-30042/23
16.11.2023

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29, paragrafi 5 të rregullore (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6 pika 2 shkronja (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës të merre këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZK,
KAÇANIK, DHE KOXHAJ

- I. Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK Kaçanik, me pronësi private të personit fizik dhe Juridik
- II. Sipas propozimit të cekur në piken -I- të këtij propozimi, lidhje me shpalljen e interes publik të parcelave të pronës si vijon:
 1. Parcela Kadastrale P-70917048-00644-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 973.3 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Ismail Raka ", ZK Kaçanik
 2. Parcela Kadastrale P-70917048-00643-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 202.4 m^2$, në pronësi të personit Adnan (Feriz) Vishi , me vendodhje Rr. "Sali Bajra", ZK Kaçanik
 3. Parcela Kadastrale P-70917048-01909-15, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 2528.8 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Emsale Frangu ", ZK Kaçanik
 4. Parcela Kadastrale P-70917048-00153-24, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 202.2 m^2$, në pronësi të personit Ramiz (Afiz) Shaqiri , me vendodhje Rr " Emsale Frangu ", ZK Kaçanik
- III. Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK Koxhaj, me pronësi private të personit fizik dhe Juridik
- IV. Sipas propozimit të cekur në piken -III-të, të këtij propozimi, lidhje me shpalljen e interes publik të parcelave të pronës si vijon:
 1. Parcela Kadastrale P-70917093-00545-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 860.5 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, Rrugët Publike dhe të Pakategorizuar, me vendodhje Rr " Ramadan Xhokli ", ZK Koxhaj.
 2. Parcela Kadastrale P-70917093-00444-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 2287 m^2$, në pronësi të personit Mejdi (Azem) Deda , me vendodhje Rr. " Ramadan Xhokli ", ZK Koxhaj.

Arsyetim

Propozimi për inicimin e për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK Kaçanik, me pronësi private të personit fizik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin të rrugës " Ismail Raka" dhe " Emsale Frangu", në ZK Koxhaj, me pronësi private të personit fizik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin të rrugës " Ramadan Xhokli", ZK Koxhaj.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi


Drejtori I DUKMM-së
z. Qamil Stagova



Kryetari I Komunës
z. Besim Ilazi



SKICA MBI KËMBIMIN E PARCELAVE 644-1 DHE 643-0 Z.K.KAÇANIK



Nr.	Y	X
1	7521206.327	4677025.008
2	7521206.974	4677028.938
3	7521203.783	4677029.493
4	7521201.850	4677025.996
5	7521198.027	4677019.136
6	7521205.487	4677018.471
7	7521205.741	4677020.627
8	7521191.214	4677006.908
9	7521190.830	4677019.777
10	7521190.065	4677011.116
11	7521191.563	4677010.971
12	7521189.662	4677004.123
13	7521182.180	4677003.504
14	7521181.902	4677004.816
15	7521166.653	4677001.846
16	7521166.325	4677001.782
17	7521159.990	4677028.390
18	7521161.940	4677028.190
